

VENDIM
Nr. 530, datë 13.6.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË TREGTIMIT DHE TË CERTIFIKIMIT TË MATERIALIT
MBJELLËS DHE SHUMËZUES TË PERIMEVE, PËRVEÇ FARËS¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 9, 14 pika 3, 15 pika 3, dhe 16 pika 4, të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të perimeve, të ndryshme nga fara, për identitetin dhe cilësinë e tyre, rregullat e etiketimit, si dhe procedurat e kriteret e certifikimit.

2. Fusha e zbatimit

Ky vendim zbatohet për gjinitë dhe speciet, si dhe hibridet e tyre, të listuara në aneksin I të këtij vendimi, nënshartesat dhe pjesë të tjera të bimëve, të gjinive të tjera ose specieve a hibrideve të tyre, nëse materiali i një prej gjinive apo specieve ose të hibrideve të tyre, që përfshihen në aneksin I, është ose duhet të jetë shartuar mbi ta.

3. Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Material shumëzues”, pjesët e bimëve dhe gjithë materiali bimor, përfshirë nënshartesat, të destinuara për shtimin dhe prodhimin e perimeve.
- b) “Material mbjellës”, bimë të tëra dhe pjesë të tyre, duke përfshirë, për bimët e shartuara, komponentët e shartimit, të destinuara për mbjellje për prodhimin e perimeve.
- c) “Identitet”, tërësia e veçorive botanike, biologjike dhe morfologjike që zotëron një varietet, vlera e të cilave është e njohur dhe plotëson qëllimet e përdorimit.

II. KRITERET PËR TREGTIMITIN E MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES TË PERIMEVE, PËRVEÇ FARËS

1. Kriteret të përgjithshme për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës
Materiali mbjellës dhe shumëzues i perimeve, përveç farës, për tregtim, duhet:

- a) të ketë të përcaktuar identitetin dhe cilësinë e tij, sipas kërkesave të këtij vendimi;
- b) të jetë i certifikuar dhe të plotësojë kushtet e përcaktuara në këtë vendim;
- c) për rastet e prodhimit vendas, të jetë i pajisur me certifikatën zyrtare, sipas modelit të përcaktuar në aneksin III të këtij vendimi;
- ç) të jetë i paketuar dhe i etiketuar konform kriterëve të këtij vendimi;
- d) të plotësojë kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe atij për mbrojtjen e biodiversitetit.

2. Kërkesat teknike që duhet të plotësojë materiali mbjellës dhe shumëzues i perimeve, përveç farës

2.1. Materiali mbjellës dhe shumëzues i perimeve, përveç farës, mund të tregtohet vetëm nga furnizues të licencuar, me kusht që të plotësojë:

- a) kërkesat teknike lidhur me varietetin:
 - i) t’i përkasë një varieteti të listuar në aneksin I të këtij vendimi, dhe të jetë i regjistruar në Katalogun Kombëtar të Varieteteve për speciet perimore;
 - ii) të tregtohet me emrin e varietetit, siç është listuar në Katalogun Kombëtar;

¹ Direktiva e Këshillit nr. 2008/72/EC, datë 15 korrik 2008 “Për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës”, me CELEX nr. 32008R0072.

- b) kërkesat teknike lidhur me cilësinë:
- i) të jetë i certifikuar;
 - ii) të ketë minimumin e standardeve për gjini apo specie specifike, si vijon:
 - të ketë mjaftueshmërisht pastërti e identitet sipas varietetit të cilit i përket dhe të jetë pa defekte, si ato që dëmtojnë cilësinë e tij si material mbjellës dhe shumëzues;
 - të ketë fuqi dhe dimensione të pranueshme lidhur me dobishmërinë si material mbjellës dhe shumëzues perimor;
 - të ketë ekuilibër të përshtatshëm midis rrënjëve, kërcellit dhe gjetheve;
 - c) kërkesat teknike lidhur me shëndetin e bimës:
 - i) ku është e aplikueshme, të përputhet me kushtet përkatëse shëndetësore të bimëve të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e bimëve;
 - ii) të paktën, gjatë kontrollit vizual, të jetë i pastër nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshme që ndikojnë cilësinë ose shenja a simptoma të tyre, që ulin dobinë e materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve të gjinive dhe specieve në fjalë;
 - iii) çdo material që tregon shenja ose simptoma të dukshme të organizmave apo sëmundjeve të dëmshme, në fazën e rritjes së bimës, do të trajtohet siç duhet kimikisht ose biologjikisht, menjëherë me shfaqjen e tyre ose, sipas rastit, do të eliminohet;
 - iv) në rastin e bulbave të qepës dhe të hudhrës, materiali mbjellës dhe shumëzues bimor të rrjedhë direkt nga materiali i cili, në fazën e rritjes së bimës, ka qenë i kontrolluar dhe është gjendur i pastër nga çdo organizëm dhe sëmundje e dëmshme apo shenja ose simptoma të tyre;
 - ç) kërkesat teknike lidhur me gjurmueshmërinë:
 - i) në rritje dhe gjatë veçimit ose largimit nga materiali prindëror, materiali mbjellës dhe shumëzues i perimeve do të mbahet në lote të veçanta;
 - ii) nëse materiali mbjellës dhe shumëzues i perimeve, i origjinave të ndryshme, është vënë së bashku ose i përzier gjatë paketimit, magazinimit, transportit apo në shpërndarje, furnizuesit duhet të mbajnë evidencë, duke përfshirë përbërjen e lotit dhe origjinën e përbërësve individualë;
 - iii) përveç sa përcaktohet në nëshkronjën “ii”, materiali mbjellës dhe shumëzues i perimeve të tregtohet vetëm në lote të mjaftueshme e homogjene dhe të shoqërohet nga dokumenti i furnizuesit;
 - d) kërkesat teknike lidhur me etiketimin:
 - i) materiali që plotëson të gjitha kërkesat për tregtim, sipas këtij vendimi, etiketohet me etiketën e furnizuesit dhe/ose shoqërohet me një dokument të bërë nga furnizuesi;
 - ii) dokumenti dhe/ose etiketa e furnizuesit kërkohet për të gjitha sasitë e materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve deri te shitësi i fundit;
 - iii) në rastin e furnizimit nga ana e furnizuesit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve për një konsumator joprofesionist, kërkesat për etiketim mund të kufizohen në përshtatjen e informacionit të produktit dhe nuk është e nevojshme të tregtohet në lote.

2.2 Procedurat për kryerjen e kontrolleve zyrtare të gjurmueshmërisë, në përputhje me kërkesat e nënshkronjave “i” dhe “ii”, të shkronjës “d”, të pikës 2.1, përcaktohen me urdhër të ministrit.

3. Etiketimi i materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës

3.1 Dokumentacioni i furnizuesit/etiketa përmban:

- a) dokumentin e furnizuesit, me të dhënat e mëposhtme:
 - i) treguesin e cilësisë;
 - ii) treguesin e kodit të shtetit;
 - iii) treguesin e organit zyrtar përgjegjës ose kodin e tij;
 - iv) regjistrimin ose numrin e licencës;
 - v) emrin e furnizuesit;
 - vi) serinë individuale ose numrin e serisë;
 - vii) datën e lëshimit të dokumentit të furnizuesit;
 - viii) numrin e referencës së lotit të farës, në rastin e bimëve të reja të rritura direkt nga fara, të tregtuara në përputhje me aneksin II të këtij vendimi dhe aneksin IV të vendimit “Për tregtimin e farës së perimeve”;

ix) emrin që përdoret zakonisht ose, kur materiali është i shoqëruar me një pasaportë bimore, emrin botanik;

x) emërtimin e varietetit. Në rastin e nënshartesës, emërtimin e varietetit ose përcaktimin e tij;

xi) sasinë;

xii) emrin e vendit të prodhimit, në rastin e importeve nga vendet joanëtare të BE-së.

b) pasaporta e bimës, në rastet kur materiali shoqërohet me një pasaportë fitosanitare të bimës, sipas kërkesave të shëndetit të bimëve, me kërkesë të furnizuesit, mund të zëvendësojë dokumentin e furnizuesit sipas shkronjës “a” të kësaj pike. Në rastet kur ky informacion mund të jetë në të njëjtin dokumentacion, dokumenti si pasaportë e bimës duhet të jetë i ndarë qartësisht dhe të përmbajë këto të dhëna:

i) treguesin e cilësisë;

ii) treguesin e organit zyrtar përgjegjës;

iii) emërtimi i varietetit;

iv) në rastin e importeve nga vendet joanëtare të BE-së, emrin e vendit të prodhimit.

c) informacionin shtesë, në rastet kur kërkohet, i cili mund të jetë:

i) në të njëjtin dokument si pasaportë bime;

ii) qartësisht i ndarë.

3.2 Etiketa zyrtare është sipas aneksit II të këtij vendimi, dhe aneksit IV të vendimit “Për kriteret e tregimit dhe certifikimit të farave të perimeve”.

3.3 Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i perimeve, përveç farës që importohet nga vendet joanëtare të BE-së, tregtohet nëse plotëson kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

III. CERTIFIKIMI I MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES I PERIMEVE, PËRVEÇ FARAVE

1. Dokumentacioni dhe procedura e certifikimit

1.1 Procedurat e certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farave, realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjekte publike apo private sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

1.2 Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farave, të prodhuara në vend dhe procedura e certifikimit të tyre janë, si më poshtë vijon:

a) Për certifikimin e materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farave, pranë autoritetit certifikues duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

i) kërkesa me shkrim për certifikimin e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farave;

ii) licenca përkatëse e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit;

iii) aktkontrolli për caktimin e ngastrës së materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës e zbatimin e kërkesave agroteknike dhe teknologjisë së prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farave, sipas metodikave të hartuara për materialin mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farës;

iv) certifikata e origjinës që vërteton pastërtinë gjenetike të varietetit;

v) certifikata fitosanitare, lëshuar nga shërbimi fitosanitar;

vi) akaprobimi fushor;

vii) fletanaliza laboratorike e treguesve cilësorë, për çdo varietet dhe lot që certifikohet, lëshuar nga laboratorit, i miratuar nga ministri;

viii) etiketa e prodhuesit;

ix) deklarata e konformitetit.

b) Autoriteti certifikues ndjek këtë procedurë certifikimi:

i) verifikon dokumentacionin dhe kontingjentin e materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farave, që do të certifikohet dhe verifikon nëse varieteti është i regjistruar në Katalogun Kombëtar. Pasi konstaton plotësimin e kërkesave për dokumentacionin e mësipërm mban procesverbalin për verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionin si dhe kontrollin e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve, përveç farave;

ii) përgatit dosjen e certifikimit për vlerësim, mbi bazën e procesverbalit dhe me dokumentacionin e mësipërm;

iii) në bazë të vlerësimit të dosjes, lëshon certifikatën zyrtare në të cilën shënohet sasia dhe numri i serisë së etiketave zyrtare që i jepen prodhuesit;

iv) etiketa zyrtare vendoset në çdo njësi paketimi, sipas numrit të serisë, të përcaktuar në certifikatën zyrtare;

v) certifikata zyrtare lëshohet pasi të jetë likuiduar tarifa e certifikimit dhe të jenë plotësuar e tërhequr nga prodhuesi sasi të dhe etiketa zyrtare.

1.3 Procedura e vlerësimit të dosjes së certifikimit, si dhe lëshimi i certifikatës zyrtare të përfundojë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim.

1.4 Nëse subjekti i autorizuar nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve për kryerjen e procedurave të certifikimit nuk e përfundon këtë procedurë brenda afatit të përcaktuar më lart, atëherë të interesuarit dorëzojnë ankesë pranë ESHFF-së.

1.5 Nëse ESHFF-ja nuk e përfundon procedurën e certifikimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 1.3 të këtij kreu, atëherë të interesuarit dorëzojnë ankesë pranë ministrit.

1.6 Forma, përmbajtja dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet kërkesës për certifikim janë sipas aneksit III të këtij vendimi.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI I LISTA E GJINIVE DHE SPECIEVE

<i>Allium cepa</i> L.	Qepa
— <i>Cepa</i> Group	Grupi i qepëve
— <i>Aggregatum</i> Group	Qepa e njomë
<i>Allium fistulosum</i> L.	Qepa e Welsh-it
<i>Allium porrum</i> L.	Prasi
<i>Allium sativum</i> L.	Hudhra
<i>Allium schoenoprasum</i> L.	Chives
<i>Anthriscus cerefolium</i> (L.) Hoffm.	Chervil
<i>Apium graveolens</i> L.	Selino
<i>Asparagus officinalis</i> L.	Asparagus
<i>Beta vulgaris</i> L.	Panxhari i kuq
<i>Brassica oleracea</i> L.	Lakra kale
	Lulelakra
	Brokoli
	Lakra e Brukselit
	Lakra e Savojës
	Lakra e bardhë
	Lakra e kuqe
	Kohlrabi
<i>Brassica rapa</i> L.	Lakra kineze
	Turnip
<i>Capsicum annuum</i> L.	Speci

<i>Cichorium endivia</i> L.	Endiviet
<i>Cichorium intybus</i> L.	Çikoret gjethe Çikore industriale
<i>Citrullus lanatus</i> (Thunb.) Matsum. et Nakai	Shalqiri
<i>Cucumis melo</i> L.	Pjepri
<i>Cucumis sativus</i> L.	Kastraveci
<i>Cucurbita maxima</i> Duchesne	Kungulli i dimrit
<i>Cucurbita pepo</i> L.	Kungulli i njomë
<i>Cynara cardunculus</i> L.	Angjinare
<i>Daucus carota</i> L.	Karrota
<i>Foeniculum vulgare</i> Mill.	Finoku
<i>Lactuca sativa</i> L.	Sallata
<i>Lycopersicon esculentum</i> Mill.	Domatja
<i>Petroselinum crispum</i> (Mill.) Nyman ex A. W. Hill	Majdanozi
<i>Phaseolus coccineus</i> L.	Fasulja bishtajëgjatë
<i>Phaseolus vulgaris</i> L.	Barbunja
<i>Pisum sativum</i> L. (partim)	Bizelja
<i>Raphanus sativus</i> L.	Rrepat
<i>Rheum rhabarbarum</i> L.	Rhubarb
<i>Scorzonera hispanica</i> L.	Scorzonera
<i>Solanum melongena</i> L.	Patëllxhani
<i>Spinacia oleracea</i> L.	Spinaqi
<i>Valerianella locusta</i> (L.) Laterr.	Valeriana
<i>Vicia faba</i> L. (partim)	Batha
<i>Zea mays</i> L. (partim)	Misri i ëmbël

ANEKSI II ETIKETA

A. Etiketa zyrtare

I. Informacioni i kërkuar

1. “Rregullat dhe standardet”.
2. Autoriteti certifikues dhe shtetin anëtar ose inicialet e tyre.
3. Muaji dhe viti i vulosjes e shprehur kështu: “vulosur ... (muaji dhe viti)”, ose muaji dhe viti i marrjes të mostrës së fundit për qëllime certifikimi, e shprehur kështu: “mostra ... (muaji dhe viti)”.
4. Numri i referencës së lot-it.
5. Speciet e treguara të paktën në shkronja romake, me emrin e tyre botanik, që mund të jepet në formën e shkurtuar dhe pa emrat e autorëve, ose emrin e tij të zakonshëm, ose të dyja.
6. Varieteti, i treguar të paktën me shkronja romake.
7. Vendi i prodhimit.
8. Në rastin e varieteteve të cilat janë hibride ose linja inbrede:
emri e komponentit, nën të cilin ajo ka qenë pranuar zyrtarisht, me ose pa referencë të varietetit final, shoqëruar, në rastin e hibrideve apo linjave inbrede të cilat janë të destinuara vetëm si komponentë për varietetet finale, nga fjala “komponent”.

B. Etiketa e furnizuesit ose mbishkrimi mbi paketat

I. Informacioni i kërkuar

1. “Rregullat dhe standardet”.
2. Emri dhe adresa e personit përgjegjës për ngjitjen e etiketave ose shenjën e tij të identifikimit.
3. Viti i vulosjes për tregtim ose i verifikimit të fundit të fuqisë mbirëse. Mund të shënohet dhe viti i fundit i lejuar për tregtim.
4. Speciet, të treguara të paktën me shkronja romake.

5. Varieteti, i treguar të paktën me shkronja romake.

Model 1

ANEKSI III
FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT QË BASHKËNGJITET KËRKESËS PËR
CERTIFIKIM
Kërkesë për certifikim

Drejtuar: Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF).

Tiranë

Për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor,parashikuar në nenin 15 të ligjit nr. 10 416 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

Të dhëna për furnizuesin:

1. Emri e mbiemri:.....
2. Adresa :
3. Emërtimi i subjektit dhe adresa:
4. Nr. NUIS (nga QKR)
5. Nr. personal i identifikimit:.....

Të dhëna për përfaqësuesin e autorizuar:

1. Emri e mbiemri:
2. Adresa:
3. Nr. personal i identifikimit:

Të dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkohet të prodhohet:

Nr.	Specia	Varieteti	Kategoria	Sasia	Vendi i prodhimit*	varieteti i regjistruar ne katalogun kombëtar (KK)
1						
2						
3						
4						
5						
6						

Afati kohor i tregimit:

Furnizuesi:

.....
Emri, mbiemri, firma dhe vula

Vendi dhe data:

Model 2

ENTI SHETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE

SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PROCESVERBAL

MBI CAKTIMIN E NGASTRËS SË FARËS

Mbahet sot, më datë, në ekonominë, fshati, komuna....., rrethi....., për caktimin e ngastrës së farës të kulturës, kultivari....., (hibridi)....., që do të mbillet me farë të Riprodhimit, gjatë vitit.....

Kjo ngastër fare caktohet në ekonominë e, me sip.ha, në kushte (mbi ose nën ujë), dhe me distancë izolimi në hapësirë nga kultivarët e tjerë prej m.

Për realizimin e prodhimit të farës prej, furnizuesi merr përsipër të zbatojë këto hallka të teknologjisë:

1.
2.
3.
4.
5.
6.

Procesverbali mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga DRB përkatëse dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

FURNIZUESI SPEC. DRB-së

SPEC. I CERTIFIKIMIT ZYRTAR ESHFF

Model 3

ENTI SHETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

CERTIFIKATË E ORIGINËS

PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND

(Bazuar në ligjin nr. 10 416, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, datë 7.4.2011, neni 16/c”).

Në mbështetje të ligjit nr. 10416 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, datë 07.04.2011, neni 16/c”, nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore lëshoj këtë Certifikatë – Origjine, për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, me të dhënat e mëposhtme:

Specia:

Varieteti:

Riprodhimi:

Numri referencës:

Numri i serisë së Etiketës Zyrtare:

Viti i prodhimit:
Vendorigjina:

FURNIZUESI

.....
(Firma, vula)

Tiranë, më.....

Model 4

**ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI CERTIFIKIMIT ZYRTAR**

**AKT KONTROLI
PËR PARCELËN E FARËS**

(Bazuar në nenin 16/a të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011,
“Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”).

I mbajtur sot, më datë, në parcelat e prodhimit materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, te furnizuesi z....., Qarku: Komuna:.....; Parcela (vendndodhja):..... mbi zbatimin e teknologjisë për prodhimin e farës Specia: kultivari:....., riprodhimi:, të mbjella në një sipërfaqe prej ha.

Nga kontrolli zyrtar rezultoi se janë zbatuar këto kushte teknike të përcaktuara;

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

Ky akt kontrolli mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga DRB-së përkatëse dhe një kopje dorëzohet në Sektorin e Certifikimit Zyrtar në ESHFF.

Model 5

**AKT APROBIMI
PËR NGASTRËN E PRODHIMIT TË FARËS**

(Bazuar në ligjin nr. 10 416 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, datë 7.4.2011, neni 16, pika 1/a)

Sot, më datë prej specialistëve të Sektorit të Certifikimit Zyrtar të ESHFF Z....., u bë aprobimi fushor i ngastrës së farës (Nr. ose emri)....., në ekonominë e furnizuesit z....., fshati, komuna

1. Nga të dhënat cilësore të farës rezulton :

- Ngastra është mbjellë me farë të: specia,, kultivari.....,
- Riprodhimi; sipërfaqjaha ; dokumenti i origjinës.....

2. Mbas verifikimi del se:

- Është siguruar izolimi m.
 - Është zbatuar teknologjia
 - Sipërfaqja e vlefshme për farë ha,
- kultivari(hibridi) :, riprodhimi:, sasia e farës që parashikohet të merretkv, kategoria:

3. Gjendja e zhvillimit të bimëve në çastin e aprobimit paraqitet :

.....
.....
.....

4. Treguesit e aprobimit fushor:

- Pastërtia varietore% (.....)
- Pastërtia nga barërat e këqija % (.....)
- Prekjet nga sëmundjet virusale % (.....)
- Prekjet nga sëmundjet kërpudhore% (.....)

..... (.....)
..... (.....)
5. Dëmtime nga dëmtuesit (.....)
6. Detyrimet e furnizuesit për trajtimin deri në tregtim:.....
.....
.....
.....

FURNIZUESI

GRUPI I APROBIMIT

.....

() () ()

)

DEKLARATË KONFORMITETI

Unë i nënshkruari, z me licencë nr., datëkod fiskal nr....., datë, me adresë, sot më datë, deklaroj në përgjegjësinë time personale se materiali mbjellës bimor.....

i prodhuar nga ana ime është konform këtij specifikimi teknik:

1. Është i shoqëruar me certifikatën e origjinës nr., datë
2. Është i shoqëruar me certifikatën fitosanitare nr., datë
3. Është i shoqëruar me rezultatin e analizës nr., datë
4. Specia
5. Varieteti
6. Riprodhimi
7. Cilësia
8. Është i ambalazhuar në, me peshë
9. Është i etiketuar me etiketa të lëshuara nga
dhe i përket lotit nr.

Lëshoj këtë deklaratë konfirmiteti komform ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, neni 11 dhe 12, si dhe mbaj përgjegjësi për vërtetësinë e specifikimeve teknike të bëra në këtë deklaratë.

datë

DEKLARUESI

(.....)

Model 7

**ENTI SHETETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR
PROCESVERBAL**

Mbi verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionit si dhe kontrollin e cilësisë së farës

Në zbatim të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, midis specialisteve të certifikimit zyrtar z. dhe furnizuesi sot me datë, mbahet ky procesverbal, për verifikimin e treguesve cilësorë dhe dokumentacionin për farën e prodhuar/importuar si vijon:

1. Furnizuesi, ka prodhuar/importuar farë të species, me këto tregues:

- a) Varieteti
- b) Riprodhimi
- c) Viti i prodhimit.....
- d) Kontingjenti
- e) Nr. Lotit
- f) Etiketa me Nr. Serie.....

Dokumente që disponon :

- a) Certifikate origjine Nr....., datë.....
- b) Certifikate fitosanitare Nr....., datë.....
- c) Fletë analize Nr....., datë.....
- d) Akt aprobimi Nr....., datë.....
- e) Deklaratë konfirmimiti Nr....., datë.....
- f) Proces verb. e kontrollit Nr., datë.....

Nga verifikimit i dokumenteve si dhe nga rezultatet e analizave laboratorike rezulton se fara është e prodhuar në përputhje me specifikimet teknike, prandaj duhet të pajiset me certifikatë zyrtare, pasi subjekti të ketë shlyer tarifën e certifikimit, në shumën lekë.

FURNIZUESI

.....

SPECIALISTËT E CERTIFIKIMIT ZYRTAR

(.....) (.....)

Model 8

MINISTRIA E BUJQËSISË USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE
LABORATORI QENDROR I TESTIMIT TË FARAVE

Vula e laboratorit

FLETANALIZA E LOTIT TE FARËS

E LËSHUAR PËR APLIKANTIN PA PËRGJEGJËSINË E LABORATORIT				
Emri i aplikantit				
Specia	Kultivari	Kategoria	Pesha e lotit	Nr. i ref. së lotit

INFORMACION

Laboratori i testimit		Shtetëror		
Mostra e sjellë nga		Zyrtare		
Nr. lotit		Natyra e certifikatës		
Vula e lotit				

Nr. i mbajtësve	Data e mostrimit	Data e pranimit	Data e testimit	Numri i testit

REZULTATI ANALIZËS

Emri shkencor i species

Pastërtia			Nr. ditëve të testit	Mbirja					Lagështia %
% ne peshe				në %					
Farë Pastër	Lëndë inerte	Fara tjera		Filiza normal	Fara të forta	Fara të freskëta	Fara anormale	Fara të vdekura	

Lloji i lëndës inerte.....

Fara të tjera

Përgjegjësi i laboratorit

MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
ENTI SHTETEROR I FARAVE DHE FIDANAVE
AUTORITETI CERTIFIKUES

CERTIFIKATË ZYRTARE

“PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND”
FARA

NR. _____, DATË _____.

Në mbështetje të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, neni 14, Sektori i Certifikimit Zyrtar, pasi administroi dokumentacionin teknik të përcaktuar në nenin 15 dhe 16 të këtij ligji, dhe e vlerësoi atë të rregullt, lëshon këtë Certifikatë Zyrtare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, të prodhuar në vend, me të cilën konfirmon se:

Loti i farës i mëposhtëm, është prodhuar nga furnizuesi _____, sipas procedurave teknike të përcaktuara, është pajisur me etiketën zyrtare të lëshuar nga ESHFF dhe ka të dhënat që vijon;

Specia
Varieteti
Kategoria.....
Kodi i furnizuesit.....
Pesha e lotit
Lloji i njësisë së paketimit
Pesha e njësisë së paketimit.....
Numri i serisë të etiketës zyrtare
Numri i analizës kontrollit, ESHFF.
Ngjyra e etiketës zyrtare

SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PËRGJEGJËSI

Tiranë, më.....